



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/

Datë: 19.04.2021

Procesverbal

i mbledhjes se III (tretë) të rregullt për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2020/21.
2. Debat lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
3. Shqyrtimi i kërkesave.
4. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 12.03.2021 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, a keni diçka rreth rendit të ditës?

Alban Krasniqi: Unë kam një numër çështjesh që duhet t'i ngris, në mbledhjen e fundit të Kuvendit unë skam qenë prezent e që janë marrë vendime në shpërputhje, ty ofruar të dhëna të rrejshme e në lajthitje. Apeloj ngitne nivelin e debatit e jo me inati, sepse ky vend se duron edhe me tutje. Vendimi për mi marrë zyret e grupeve politike që kemi nda me vendim për të s'është thënë asnjë e vërtetë mbi qëllimin, mënyrën dhe kërkesën. I keni qite në lajthitje anëtarët tanë, kjo është mënyrë e gabuar politike e që qytetarët i kanë dënuar. Ne mund të ulemi e të bisedojmë kemi praktika e nëse ju doni me na ndalë hapësirën fjalën nuk mundeni mema ndal për mi kryer detyrat që kemi marrë mandat, ju veç keni fole por nuk keni ofru një dokument që e ka ndaluar atë vendim. U përmenden logot e partive e jo logoja e ati kafiqit që është i vendosur aty, në atë objekt as nuk ka rrymë as ngrohje, pra një kërkesë për nevojat e asamblistit nuk ka aty paligjshmëri.

Rahim Morina: Nëse keni diçka e kemi edhe pikën të ndryshme.

Hashim Vrenezi: S'jam kundër askujt por kjo çështje që po flet kolegu unë kurrë se kam pa atë vendim. Ketë temë e diskutojmë në kuvend, kam kërkuar mu sqaruar çështja e grupeve, sepse vendimi a marrë pasi që kemi menduar se kemi të drejtë se jam i prirur me besu pak.

Halil Morina: Logot i kam përmend edhe unë dhe kryesuesi na ka pas thënë se vendimi a kthy i kundërligjshëm.

Alban Krasniqi: Deputeti dhe partia politike dallojnë, administrata është dashtë me shenu, e kem marrë vendimin me dëshmi të arsyeshme, praktikën e vendosjen se ulëseve e dimë dhe ndryshon radhitja.

Rahim Morina: Kalojmë në rendin e ditës

Alban Krasniqi: Një vendim që kemi marrë për orarin e klubeve s'është punu asgjë në atë drejtim, sepse s'munden fëmijët me mbajte ushtrime aty se drejtorja e Kulturës se ka rregullu ketë çështje dhe nëse jo ketë çështje ja japim komitetit për kulturë që ta merr përsipër për me rregulluar orarin. Pra të jetë pikë Zbatimi i vendimit nga DKRS rreth orarit të klubeve.

Çështja e vendimit të Kuvendit të Komunës për menaxhimin e Covidit rreth ndarjes së pakove për familjet e varfra, subvencionimi për personat me Covid sa zbatu. Një raport mbi nivelin e zbatimit të vendimit për Covid-19. Ketë raport është dashtë kryetari me përgatitur.

Rrahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së –II- të KPF-së.

Unanimisht ishin për miratimin e procesverbalit.

2. Shqyrtimi i propozimit nr.01/147 datë:11.03.2021 dhe miratimi i Raportit të detyrimeve kontingjente për paga jubilarë dhe shujta për punëtorët e Arsimit dhe Shëndetësisë.

Mujë Sahitaj: Kam përgatitur një raport për vendimet e inspektoratit që po përballet çdo ditë DKA, lidhur me pagesat e pagave jubilarë dhe shujtave. Të gjithë këto lëndë kanë shkuar të përmbaruesi privat, nëse e aprovon ketë kërkesë për zbatimin e kontratës kolektive nuk shpenzohen mjetet në procedurë gjyqësore dhe përmbarimore. Nëse merrni vendim pra ato shpenzime nuk ngarkohen.

Halil Morina: Me bërë një përpjekje mi paguar pa përmbarues privat, ndryshe dy palët ju dëmtojnë sepse përfitojnë me shumë se pala.

Mujë Sahitaj: Këto vendime janë të formës së prerë.

Hashim Vrenezi: Kjo kërkesë vjen prej zyrës së Avokatit sikur me kanë krejt një institucion tjetër. A keni konsultuar kryetarin dhe drejtoritë, se vet drejtori i DKA ka dalë kundër kësaj kërkesë, është dashtë mu konsultuar me kryetarin, drejtoritë, nivelin qendror dhe ka mujt me ardhe si kërkesë para miratimit të buxhetit.

Raimonda Krasniqi: Ne duhet të bëjmë zgjidhje sa është kontrata kolektive në fuqi, jam në mbështetje të propozimit qysh me gjete një zgjidhje, sepse su bë zgjidhje por faji hidhet pse e kanë miratuar kontratën kolektive.

Alban Krasniqi: Kërkesa duhet të jetë nga kryetari e parashtruar, duhet të jetë një raport i Drejtorisë për Financa. Kemi pas thënë t'i bartim mjetet në paga dhe mëditje nuk patën pranuar, tani duhet një komunikim edhe me Ministrinë e Financave, nëse është nevoja dikush edhe nga KpF vijmë në Ministri.

Hashim Vrenezi: Çka ka ndodhur me shujtat e shërbyesve civil që kemi marrë vendim në kuvend.

Valon Mazreku: Fondi rezervë nr.20 nga Ligji i pagave kur ka ardhe njoftimi prej Mef-it thanë se këto mjete mund të shfrytëzohen në kodin ekonomik përjashtimisht paga e mëditje. Ska përcaktim se ku mund të merren ato mjete sepse sa përcaktuar, forma e vetme është përmes kategorisë pagave por problemi ka qenë mi planifikuar sepse s'kemi mund me rritë kategorinë e pagave. Edhe këto obligime tash kanë kosto e këto bëhen veç nga kategoria e pagave. Forma mi paguar shujtat e administratës bëhet që vendimet e inspektoratit mi regjistruar si furnitor edhe arsimtaret.

Rrahim Morina: Në Mef na kanë thënë Gjykata veç pyet nga cili zë ju marrim mjetet, mi ndal s'mundesh.

Hashim Vrenezi: Duhet me pas një fond për detyrimet kontingjente se mundet nesër me të ndodhë një detyrim.

Valon Mazreku: Kur vijnë qarkoret buxhetore Mef përcakton tavanet e ne s'mundemi me ndërhyrë sepse janë të kufizuara.

Hashim Vrenezi: Të krijoni një rregull që nesër të zbatohet.

Rrahim Morina: Mirë është ta autorizojmë drejtorin të shkojë në Mef të merr një përgjigje për zbatimin e procedurave ligjore dhe në kuvend të vendoset.

Mujë Sahitaj: Ne mundemi para urdhrat përmbarues të inspektoratit me gjete një zgjidhje

Hashim Vrenezi: Unë kërkoj me ditë sakte se ku merren paratë.

Unanimisht ishin që drejtori i Financave të merret me këtë çështje.

3. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2020/21.

Raimonda Krasniqi: Problemi që kërkoj shpjegim është te programi E-shkollori, sepse është i hapur në kohë të shkurtër dhe problem është te qasemi, a mundmi në ndonjë qasje tjetër.

Cilat Shkolla janë rinovuar deri tani dhe cilat janë në proces të renovimit.

Në cilat Shkolla janë në proces të ndërtimit fushat e futbollit.

Deri ku kanë shkuar procedurat për rregullimin e oborreve të shkollave dhe për cilat shkolla.

Kur do të përfundojnë sallat sportive të shkollave “Emin Duraku” dhe Ibrahim Mazreku”

Lidhur me dezinfektimin e hapësirave shkollore, inspektimin e bënë Inspektorati apo ndonjë grup tjetër.

A është bërë furnizimi i shkollave me material higjienik dhe material dezinfektues.

Transporti i nxënësve në fshatrat Garaqevë, Panorc dhe Janqist a është realizuar deri me tani, këtë vit a është planifikuar transporti i nxënësve të këtyre fshatrave.

A keni paraparë transportin e nxënësve të shkollës “Hasan Prishtina” pasi që këta nxënës janë të rrezikuar, sepse e kanë largësinë mbi 3.5 km.

Alban Krasniqi: Është jo serioze me thanë në realizim e sipër, secili projekt e ka në nivelin e realizueshmërisë të matshëm.

Të sillen listat e aplikuesve për vendet e punës nëpër shkollat, sa konkurse janë anuluar, cilat janë anuluar dhe arsytet e anulimit.

Lidhur me konkursin e shpallur për drejtor të Shkollave, kërkohet Raport, cila është gjendja aktuale, sa drejtor të Shkollave janë ushtrues detyre deri me tani nëpër Shkolla, që sa kohë janë dhe pse kaq gjatë kanë qenë ushtrues detyre.

Ashiqare krejt ky proces me fut militant drejtor e jo njerëz të duhur.

Në situatën kur kryetari spo ka mundësi me ushtruar detyrën dhe me udhëheqë e tash me shpallë konkurs e kur aj duhet mi nënshkruar kontratat e këta nuk bënë me keqpërdorë këtë. Për kaq pak kohë sa ka mbete ato vende i kisha lënë deri në udhëheqjen e re, sa kanë qenë ushtrues detyre se nesër mund të sfidohen.

Halil Morina: Këto çështje i adresojmë në Kuvend.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Debat lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.01/120 datë: 04.03.2021 të parashtruar nga kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.01/14 datë: 19.01.2021 të parashtruar nga z.Bexhet Paçarizi pronar i NTS “NEZIRI” nga fshati Dragobil.

Alban Krasniqi: Kur kryetari drejtohet me shkresë duhet me sjellë edhe arsyeshmerinë a është me plan, duhet të shpallet zonë për ndërtim, sepse momentalisht si kemi as hartat zonale pastaj duhet të shpallet ankand publik.

Muharrem Morina: Me Ligj zonat që komuna parasheh mi dhëne duhet t’i listojë, kuvendi merr vendimin dhe i shpallë.

Rahim Morina: Kryetari me ligj obligohet me sjellë arsyeshmerinë në Kuvend.

Hashim Vrenezi: Mos të bimë në lajthitje kur të caktojme një zonë duhet me pa kush ofron kushte me te mira.

Alban Krasniqi: Mena sjellë komuna një dokument për mi caktu zonat ekonomike dokument zyrtar, planin zhvillimor, hartat zonale.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t’i kthehet zyrës së kryetarit që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës? Unanimisht ishin për.

kërkesa nr.01/143 datë: 10.13.2021 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për zhvendosjen e stabilimenteve të vjetra dhe vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike, për nevojat e vendbanimeve.

Rekomandohet unanimitet për Kuvend.

Kërkesa nr.02/73 datë: 01.03.2021, të parashtruar nga zj. Valmire Gashi nga fshati Vermicë, Komuna e Malishevës, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike, për ngritjen e biznesit familjar me qëllim të sigurimit të kushteve ekonomike për jetë.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë ti kthehet zyrës së kryetarit që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës? Unanimitet ishin për.

Kërkesa nr.02/52 datë: 22.02.2021 të parashtruar nga banoret e Lagjes Samadraxha nga fshati Banjë, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Komunitetit.

Rekomandohet unanimitet për Kuvend.

Kërkesa nr.02/39 datë: 08.02.2021 të parashtruar nga Imer Tahir Sopaj nga fshati Janqishtë, Komuna e Malishevës, për këmbimin e pronës private me pronë publike në interes të përgjithshëm publik.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i kthehet zyrës së kryetarit që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës? Unanimitet ishin për.

Kërkesa nr.06/38 datë: 01.03.2021 të parashtruar nga z. Hysen Krasniqi nga fshati Banjë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rekomandohet unanimitet për Kuvend.

Kërkesa nr.02/356 datë: 25.09.2020, për planifikim të buxhetit për personat e prekur nga kanceri dhe sëmundje tjera të parashtruar nga anëtarja e kuvendit Sadije Krasniqi.

Hashim Vrenezi: Ekzistoj një fond për përfutjesit individual dhe janë edhe kriteret.

Alban Krasniqi: Në buxhet spo kemi e anën tjetër kemi shumë kërkesa, por shumë është në pyetje jeta e njerëzve.

Rekomandohet unanimitet për Kuvend.

Rahim Morina: Tani i kemi disa kërkesa për ndihmë financiare.

Hashim Vrenezi: Sa mujta disa mi pa kishte dokumente shumë të hershme sidomos ato me probleme shëndetësore që janë drejtuar në KpF.

Alban Krasniqi: Në duhet me ba një kriter që nëse nuk na sjellin ndonjë dokument që nuk është ndihmuar prej Komunës-Kryetarit ose prej Ministrisë dhe jo me i vjetër dokumente se 6 muaj, pastaj në meju ndihmu

Kërkesa nr.02/68 datë: 26.02.2021

Rahim Morina: Kjo kërkesë është përcjelle tek Komisioni.

Rahim Morina: Nëse jeni të pajtimit që këto kërkesa mi ndihmuar të gjitha me nga 500 euro? A jeni për këtë propozim? Unanimitet ishin për.

Kërkesa nr.02/97 datë: 12.03.2021 e parashtruar nga zj. Arbnore Morina nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

Unanimitet ishin që t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/71 datë: 01.03.2021 e parashtruar nga z. Hamit Hoxha nga fshati Bellanicë, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimitet ishin që t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/75 datë: 02.03.2021 e parashtruar nga z. Muhamet Krasniqi nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimitet ishin që t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/65 datë: 25.02.2021 e parashtruar nga zj. Qamile Elshani me vendbanim në Malishevë, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/53 datë: 23.02.2021 e parashtruar nga z. Ruzhdi Mazreku nga Malisheva, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të djalit të tij Malsor Mazreku.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/61 datë: 24.02.2021 e parashtruar nga z. Sefë Morina nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/69 datë: 01.03.2021 e parashtruar nga zj. Sevdije Stollitqi nga fshati Ngucat, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/55 datë: 23.02.2021 e parashtruar nga z. Edison Morina nga fshati Bubavec, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/60 datë: 24.02.2021 e parashtruar nga z. Miftar Krasniqi nga fshatin Burim, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të bashkëshortes së tij zj. Huma Krasniqi.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/34 datë: 15.02.2021 e parashtruar nga z. Naser Ulluri nga fshati Marali, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të djalit të tij Nard Ulluri.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

Kërkesa nr.02/56 datë: 23.02.2021 e parashtruar nga z. Azem Morina nga fshati Lubizhdë Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të bashkëshortes së tij zj. Fate Morina.

Unanimisht ishin qe t'i ndahen 500 euro.

6. Të ndryshme.

Rahim Morina: Çështja e uleshe për anëtarët e Kuvendit do e diskutojmë në kuvend, pastaj lidhur me deklarinë e pasurisë nga anëtarët e kuvendit duhet deri me 31 mars secili duhet me deklaruar personalisht në Agjencionin kundër korrupsion në Prishtinë.


Me ligj ulëset e anëtarëve të kuvendit nuk janë të parapara.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:45

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rahim Morina

